



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/53  
Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane, sipas propozimit të Grupit Punues të themeluar me Vendimin e Qeverisë Nr. 06/45, të datës 08.05.2018.
2. Zona e Veçantë Ekonomike Amerikane themelohet në Komunën e Gjakovës, Zona Kadastrale Gjakovë, përkatësisht në parcelat në pronësi të "KBI ERENIKU" me sipërfaqe prej 4866644 m<sup>2</sup>, në parcelat si në vijim:
  - 2.1. Parcela Nr. K1-0 me sipërfaqe prej 14206 m<sup>2</sup>;
  - 2.2. Parcela Nr. K2-0 me sipërfaqe prej 51775 m<sup>2</sup>;
  - 2.3. Parcela Nr. K3-0 me sipërfaqe prej 78953 m<sup>2</sup>;
  - 2.4. Parcela Nr. K4-0 me sipërfaqe prej 86174 m<sup>2</sup>;
  - 2.5. Parcela Nr. K6-0 me sipërfaqe prej 98811 m<sup>2</sup>;
  - 2.6. Parcela Nr. K7-0 me sipërfaqe prej 105026 m<sup>2</sup>;
  - 2.7. Parcela Nr. K8-0 me sipërfaqe prej 109771 m<sup>2</sup>;
  - 2.8. Parcela Nr. K9-0 me sipërfaqe prej 205497 m<sup>2</sup>;
  - 2.9. Parcela Nr. K10-0 me sipërfaqe prej 110634 m<sup>2</sup>;
  - 2.10. Parcela Nr. K11-0 me sipërfaqe prej 82577 m<sup>2</sup>;
  - 2.11. Parcela Nr. K12-0 me sipërfaqe prej 93505 m<sup>2</sup>;
  - 2.12. Parcela Nr. K13-0 me sipërfaqe prej 102225 m<sup>2</sup>;
  - 2.13. Parcela Nr. K14-0 me sipërfaqe prej 87499 m<sup>2</sup>;
  - 2.14. Parcela Nr. K15-0 me sipërfaqe prej 87819 m<sup>2</sup>;
  - 2.15. Parcela Nr. K16-0 me sipërfaqe prej 104610 m<sup>2</sup>;
  - 2.16. Parcela Nr. K17-0 me sipërfaqe prej 134011 m<sup>2</sup>;
  - 2.17. Parcela Nr. K18-0 me sipërfaqe prej 197423 m<sup>2</sup>;
  - 2.18. Parcela Nr. K19-0 me sipërfaqe prej 132695 m<sup>2</sup>;
  - 2.19. Parcela Nr. K20-0 me sipërfaqe prej 453592 m<sup>2</sup>;
  - 2.20. Parcela Nr. K21-0 me sipërfaqe prej 537263 m<sup>2</sup>;
  - 2.21. Parcela Nr. K22-0 me sipërfaqe prej 246663 m<sup>2</sup>;

- 2.22. Parcela Nr. K23-0 me sipërfaqe prej 270820 m<sup>2</sup>;
  - 2.23. Parcela Nr. K24-0 me sipërfaqe prej 190092 m<sup>2</sup>
  - 2.24. Parcela Nr. K25-0 me sipërfaqe prej 217098 m<sup>2</sup>;
  - 2.25. Parcela Nr. K26-0 me sipërfaqe prej 231686 m<sup>2</sup>;
  - 2.26. Parcela Nr. K27-0 me sipërfaqe prej 207110 m<sup>2</sup>;
  - 2.27. Parcela Nr. K28-0 me sipërfaqe prej 198886 m<sup>2</sup>;
  - 2.28. Parcela Nr. K29-0 me sipërfaqe prej 129186 m<sup>2</sup>;
  - 2.29. Parcela Nr. K30-0 me sipërfaqe prej 54537 m<sup>2</sup>;
  - 2.30. Parcela Nr. K35-0 me sipërfaqe prej 246500 m<sup>2</sup>.
3. Zyra e Kryeministrit do të koordinojë gjithë procesin e themelimit të Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane, sipas propozimit të Grupit Punues, në bashkëpunim me institucionet tjera kompetente.
  4. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të zhvillojë të gjitha procedurat e shpronësimit të parcelave nga paragrafi 2. i këtij Vendimi.
  5. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës si dhe të gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi.
  6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/53

Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, me nr. prot. 3326-18, datë 21.06.2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit - Ndërtimi i Lokacionit të "Varrezave" ZK Neqavc, Komuna Hani i Elezit, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokollit 5519/17, datë 02.11.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Ramush HARADINAJ**



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/53

Datë: 26.06.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 07/138 të datës 22.03.2017**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë Nr. 07/138 të datës 22.03.2017, kështu që, në vend të z. Fridon Lala, anëtar i Bordit Menaxhues të Lotarisë së Kosovës emërohet z. Abdyl Leci.
2. Ky Vendim paraqet pjesë përbërëse të Vendimit Nr. 07/138, të datës 22.03.2017 i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 07/141, datë 07.04.2017.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/53  
Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Shëndetit Riprodhues dhe Fertilizimin e Asistuar.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/53


Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Shpronësimit të Pronës së Paluajtshme.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/53


Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Rregullimin e Fushës nga Marrëdhënia e Punës.
2. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/53  
Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Infrastrukturës për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Malit të Zi dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Udhëtarëve dhe Mallrave.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Infrastrukturës obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/53

Datë: 26.06.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 qershor 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 30,000,00 (tridhjetmijë) euro për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjekësor jashtë vendit të z. Bujar Bukoshi.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave, nën programi i Thesarit me kod 11200, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere. Këto mjete transferohen në xhirollogarinë IBAN:DE77 7316 0000 0502 5112 15 BIC:GENODEF1MIR. PROF.DR.HARTWIG LUDWIG BAUER.BANKA : GENOSSENSCHAFTSBANK UNTERALLGAEU EG,DEUTSCHLAND.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë